

A K T - T H E M E L U E S

Kontrate

I

SHOQERISE TREGTARE

INFOSOFT PLUS SH.P.K.

Ne mbeshtetje te nenit 2, §1, shkronja "ç" te ligjit te Kuvendit Popullor te Republikes se Shqiperise nr. 7512 date 10/08/1991 "Per sanksionime dhe mbrojtje e prones private te nismes se lire te veprimtarive private te pavarura dhe privatizimit"; Ligjit 7638 date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregtare"; Ligjit 7594 date 4.08.1992 "per invstimet e huaja" dhe mbi bazen e ligjit 7667 date 28.10.1993 " Per Rregjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare", personat private:

Z. CIRO RINALDI qytetar italian

Z. Grigor JOTI qytetar shqiptar

Z. Genci RADOVICKA qytetar shqiptar

si themelues te Shoqerise se perbashket, sot me date 29.09.1993 duke patur zotesine ligjore per te vepruar ,

U MUARREM VESH DHE KONTRAKTUAM

per sa vijon:

F O R M I M I  
Artikulli 1

Formohet Shoqeria Tregtare me pergjegjesi te kufizuar ne emertimin "INFOSOFT PLUS SH.P.K." e ortakeve themelues:

1.Ciro RINALDI, shtetas italian, lindur me 12.09.1959, ne Palermo dhe banues ne Palermo.

2.Grigor JOTI, shtetas shqiptar, lindur me 13.02.1956 ne Korce dhe banues ne Tirane, Rr. Ali Baushi, P7/7/65.

3.Genc Radovicka, shtetas shqiptar lindur me 10.08.1961, ne Tirane dhe banues Rr. Bul. Marsen Kashen, P1/1/5.

Artikulli 2

SH.P.K.

SH.P.K. Selia i Shoqerise Tregtare "INFOSOFT PLUS" eshte aktualisht ne Rr. Mihal Duri Nr. 7 .

KOHEZGJATJA  
Artikulli 3

Shoqeria Tregtare "INFOSOFT PLUS SH.P.K." ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj ekonomike 10 vjet. mbi

OBJEKTI I VEPRIMTARISE  
Artikulli 4

Objekti i veprimtarise ekonomike te Shoqerise Tregtare "INFOSOFT PLUS SH.P.K." Eshte sipas pershkimit qe behet ne artikullit 4 te Statutit te kesaj Shoqerie.

KAPITALI I SHOQERISE  
Artikulli 5

Kapitali fillestar i Shoqerise Tregtare "INFOSOFT PLUS SH.P.K." eshte prej 5000 USD i formuar si vijon nga ortakët themelues te shoqerise

ORTAKET	shuma	ne % ndaj totalit
1 Ciro Rinaldi	1750	35 %
2 Grigor Joti	2080	41.6 %
3 Genc Radovicka	1370	27.4 %
-----		
<u>GJITHSEJ</u>	5000 USD	100 %

Kuotat e kapitalit te cdo ortaku te Shoqerise do te derdhen ne llogarine bankare te kesaj Shoqerie brenda afatit te caktuar nga ortakët. Ortaku qe nuk derdh ne afatin e caktuar kuotat e tij te kapitalit mund te perjashtohet nga Shoqeria.

Artikulli 6

Kuotat e pjesemarrjes ne kapital jane te gjitha te emertuara e te pandashme. Ato nenshkruhen, shlyhen plotesisht dhe pastaj ndahen midis ortakeve sipas perpjestimit pjesemarrës te secilit ne formimin e kapitalit themelor.

Cdo kuote i takon e drejta e nje vote.

Pjeset e kapitalit themelor mund te transferohen vetem me pelqimin e te gjithe ortakeve duke u evidencuar me shkrim dhe regjistruar ne Regjistrin Tregtar, formalitetin per ndryshimin e Statutit.

Artikulli 7

Ortaku qe ka ndermend t'iu shese te treteve kuota te tija, teresisht ose pjeserisht duhet te njoftoje me pare ortakët e



tjere te Shoqerise, te cilet kane te drejten e blerjes se pare. Kjo e drejte duhet ushtruar brenda tridhjete diteve nga data e komunikimit. Ne rast mos ushtrimi te te drejtes se blerjes se pare, ortaku qe ka ndermend te shese kuota te kapitalit te tij, duhet t'iu komunikojte ortakeve te tjere emrin e bleresit te ri si dhe kushtet e shitjes.

Kushtet e shitjes se kuotave ne te trete se sa ato ofruar ortakeve te Shoqerise, tecilet jane te preferuar ne kushte te barabarta. Ne blerjen e kuotave prej tyre ruhen perpjestimet e kuotave te secilit ne formin e kapitalit themelor te Shoqerise, por pagene ky kusht i detyrueshem per cdo ortak bleres te kuotave te reja.

#### ORGANET DREJTUESE Artikulli 8

Organet drejtuese te Shoqerise Tregtare "INFOSOFT PLUS SH.P.K." jane Asambleja e Shoqerise, Keshilli Administrativ dhe Administratorin e saj.

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e punes se organeve drejtuese, emerimi e shkarkimi i anetareve dhe ceshtje te tjera te rendesishme te ketyre organe rregullohen sipas Statutit te Shoqerise qe eshte pjese perberese e ketij Akti si dhe me rregullore te tjera re brendshme te Shoqerise qe do te miratoje Asambleja e saj.

#### Artikulli 9

Shoqeria Tregtare "INFOSOFT PLUS SH.P.K." ka zgjedhur si Administrator z. Genc Radovicka.

#### Artikulli 10

Vendimet e Asamblese jane te vlefshme nese jane pranuar nga shumica e kapitalit te Shoqerise ndersa per ceshtje qe trajton mbledhja e Asamblese se jashtezakonshme kerkohet miratimi nga 3/4 e kapitalit te Shoqerise.

Shoqeria Tregtare zbaton edhe dispozita normative urdheruese te Ligjit 7638 date 19/11/1992 "Per Shoqerite Tregtare"

#### Artikulli 11

Shoqeria ka vulen e saj zyrtare me permbajtje :

Shoqeria Tregtare - "INFOSOFT PLUS SH.P.K." Tirane

#### MARREDHENIET E PUNES Artikulli 12

Maredheniet e punes ne Shoqerine Tregtare "INFOSOFT PLUS SH.P.K." rregullohen sipas artikujve te Statutit te saj.

BILANCI DHE TE ARDHURAT  
Artikulli 13

Veprimet ekonomiko-financiare te Shoqerise Tregtare "INFOSOFT PLUS SH.P.K." mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti. Ne fund te cdo periudhe ushtrimore administratori nxjerr bilancin kontabel te Shoqerise me Rezultatin ekonomik Fitim-Humbje bazuar ne ligje e rregulla permbajtjen e kontabilitetit nga subjektet ekonomike duke nxjerre gjithashtu inventaret perkatese mbi gjendjen e pasurise se Shoqerise si dhe raportin mbi administrimin.

Bilanci kontabel vjetor miratohet nga Asambleja e Shoqerise.

Me miratimin e bilancit vjetor Asambleja vendos per krijimin e fondeve te ndryshme te nevojshme per zhvillimin e garantuar te saj.

Artikulli 14

Fitimi i realizuar nga Shoqeria Tregtare "INFOSOFT PLUS SH.P.K." pas vecimit te fondeve dhe detyrimeve fiskale ndahet ne mes ortakeve te saj ne perputhje me raportin e kuotes se secilit ortak ndaj kapitalit themelor te Shoqerise.

SHPERBERJA E SHOQERISE  
Artikulli 15

Shperberja e Shoqerise Tregtare "INFOSOFT PLUS SH.P.K." mund te vije ne cdo kohe dhe per cfaredolloj shkak, duke vepruar sipas kriterëve te pershkruar ne Artikullin ... te Statutit.

DISPOZITAT E PERGJITESHME.  
Artikulli 16

Te gjithe kundershtimet eventuale midis ortakeve te Shoqerise i nenshtrohen kompetences se nje kolegji prej tre arbitrash, nga te cilet secila pale ne grindje cakton nga nje arbiter, ndersa i treti caktohet nga dy te paret, ose nga Kryetari i Gjykates se Rrethit te Tiranes. Arbitrat kerkojne zgjidhje ne mirekuptim dhe vendimet e tyre do te pranohen nga oalet ne konflikt si shprehje e vullnetit te tyre. Vendimet merren ne vendin dhe kohen e parashikuar nga Asambleja e Shoqerise.

Artikulli 17

Vendimet e Kolegjit Arbitral mund te apeloohen vetem nese nje nga palet kerkon arbitrazh te metejshe pranë Gjykates se Rrethit te Tiranes ku eshte depozituar ky Akt themelues e Statut i Shoqerise Tregtare, vendimet e se ciles jane te paapelueshme te detyrueshme per palen me ekzekutim te menjehershme.

Artikulli 18

Ky Akt themelues (kontrate) perpilohet ne disa kopje per t'iu shperndare organeve kompetente : Gjykates se Rrethit per






njohjen si person juridik dhe reregjistrim ne regjistrin tregtar dhe nje kopje mbetet si pjese perberese e dokumentacionit te themelimit te Shoqerise Tregtare "INFOSOFT PLUS SH.P.K.".  
Akti themelues (kontrata) hyn ne fuqi dite e nxjerrjes se saj nga ortaket themelues te Shoqerise.

Kontrata firmoset rregullisht nga ortaket e Shoqerise Tregtare :

Ciro Rinaldi

Genc Radovicka

Grigor Joti



Tirane me 29/09/1993.